

DEKRET
Nr. 437, datë 5.12.2025

PËR DHËNIE DEKORATE

Në mbështetje të nenit 92, germa “ç”, nenit 93 të Kushtetutës, nenit 6, pika 1, të ligjit nr. 93/2022, “Për dekoratat në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e dekoratës “Ylli i Madh i Urdhrit Suprem të Shqiponjës” zotit Alfred Moisiu

“Në vlerësim të kontributeve të veçanta, të shquara e të qëndrueshme në interes të kombit dhe të shtetit shqiptar, përmes një jete kushtuar shërbimit, si fillim dhe për një kohë të gjatë nën uniformë, e më pas në funksionet më të larta shtetërore të Kryetarit të Shtetit, duke i ushtruar ato me integritet, vetëdije shërbimi ndaj interesit të përgjithshëm dhe me vendosmërinë e palëkundur për të garantuar pacenueshmërinë e rendit kushtetues dhe mbrothësimin e vlerave demokratike”.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj